qendra e provimeve

KATALOGU I PROVIMIT

# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

PROVIMI I MATURËS NË GJIMNAZ

VITI SHKOLLOR 2013/2014

***Katalogun e provimit e përgatiten:***

***Hava Pereziqi,*** *SHMP „V.Bashkimi" Ulqin*
***Mr. Rrok Gjolaj,*** *Gjimnazi „25 Maji" Tuz*
***Mr. Haxhi Shabani,*** *Gjimnazi „Drita" Ulqin*
***Sehad Lulanaj,*** *Gjimnazi „25 Maji" Tuz*
***Luigj Berisha,*** *Qendra e Provimeve, Podgoricë*

***Recensent: Mr. Anton Gojçaj,*** *Enti për Shkollim*

## PËRMBAJTJA


1. Hyrje....................................................................................................4
2. Rregullat ..............................................................................................5
3. Qëllimet e përgjithshme ......................................................................6
4. Struktura dhe vlerësimi i provimit .......................................................7
    4.1. Skema dhe kohëzgjatja e provimit ................................................7
    4.2. Mënyra e vlerësimit .......................................................................7
    4.3. Llojet e detyrave/pyetjeve .............................................................7
5. Përmbajtja e provimit dhe qëllimet .....................................................9
    5.1. Gjuhë ...............................................................................................9
    5.2. Letërsi ............................................................................................10
    5.3. Të shprehurit me shkrim...............................................................11
    5.4. Veprat letrare të detyrueshme ......................................................12
6. Shembulli i testit ..................................................................................13
7. Fleta e përgjigjeve ................................................................................26
8. Zgjidhja e testit me skemë për vlerësim ..............................................28
9. Literatura ..............................................................................................36

# 1. HYRJE

Matura Shtetërore në sistemin arsimor të Malit të Zi fillon të futet në vitin shkollor 2010/2011 dhe paraqet kontrollimin ekstern të standardizuar të arritjeve shkollore të nxënësve në fund të arsimimit katërvjeçar në gjimnaz. Në bazë të Ligjit për gjimnazin, (Gazeta Zyrtare e RMZ", nr. 64/02 e 28.11.2002 dhe "Gazeta Zyrtare e RMZ" 49/07 e 10.08.2007), Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kohën e dhënies së Provimit të Maturës në gjimnaz (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 34/09, 19/10, 81/10, 60/11, 65/12 dhe 50/13) Provimi i Maturës jepet në mënyrë eksterne (Neni 38), kurse për përgatitjen e materialit të provimit dhe zbatimit të procedurës së Maturës Shtetërore është e ngarkuar Qendra e Provimeve.

Kontrollohen njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë të cilat bazohen në pjesët kryesore të Programit të lëndës, që duhet t'i dinë nxënësit në fund të vitit të katërt të gjimnazit.

Në katalogun e provimit janë cekur qëllimet e përgjithshme të provimit, është përshkruar struktura e provimit, kurse me formën e qëllimeve të provimit saktësisht është thënë përmbajtja e lëndës që i nënshtrohet provimit. Në të ndodhet edhe shembulli i testit me skemë për vlerësim.

Katalogu i provimit u kushtohet nxënësve dhe mësimdhënësve.

# 2. RREGULLAT

Provimi nga Gjuha shqipe dhe letërsia do të mbahet në kushte të njëjta dhe në mënyrë të njëjtë për të gjithë nxënësit e vitit të katërt të gjimnazit.

Materiali i provimit do të paketohet në qese të veçanta dhe të sigurta, të cilat do të hapen para nxënësve menjëherë para fillimit të provimit.
Në provim nuk lejohet:

→ prezantimi i rrejshëm,
→ shikimi i detyrave të provimit para kohës së lejuar,
→ pengimi i nxënësve të tjerë,
→ përshkrimi nga nxënësi tjetër
→ shfrytëzimi i mjeteve të palejuara dhe telefonit celular,
→ dëmtimi i shifrës në librezën e testimit,
→ mosrespektimi i sinjalit për përfundimin e provimit.

**Mjetet e lejuara:** lapsi i thjeshtë,goma dhe lapsi kimik/stilolapsi.
Punimi i nxënësit **duhet** të jetë i shkruar me laps kimik/stilolaps.
Pas provimit, testet do të paketohen dhe do të kthehen në Qendrën e Provimeve, ku do të organizohet vlerësimi i tyre.

## 3. QËLLIMET E PËRGJITHSHME

Pas përfundimit të vitit të katërt të gjimnazit, nxënësi duhet:

→ të njohë normën gjuhësore dhe normën drejtshkrimore dhe t'i zbatojë ato me përpikëri

→ të ketë aftësinë e të lexuarit, të kuptuarit dhe analizimit të tekstit joletrar dhe qëllimin e tij

→ të kuptojë përmbajtjen dhe rëndësinë e tekstit letrar - artistik

→ të dijë të analizojë tekstin letrar duke shfrytëzuar nocionet letrare-teorike

→ që i pavarur të vlerësojë sferat estetike, etike dhe të njohjes së veprës së lexuar; të jetë i aftë që të shpjegojë dhe të argumentojë pohimet e veta, të shpreh përjetimin

→ të dijë të shkruajë esenë (analitike dhe interpretuese)

# 4. STRUKTURA DHE VLERËSIMI I PROVIMIT

## 4.1. Skema dhe kohëzgjatja e provimit

**Provimi zgjat 180 minuta dhe punohet pa pushim**

Provimi përbëhet nga:

→ detyrat/pyetjet nga gjuha dhe letërsia
→ shkrimi i esesë (nga 250 deri në 300 fjalë)

## 4.2. Mënyra e vlerësimit

***Detyrat/pyetjet – 60%***
***Shkrimi i esesë – 40%***

Rezultati i nxënësit/e nxënëses në test do të caktohet si në vijim: numri i pikëve të fituara nga zgjidhja e pjesës së parë të provimit, në rezultatin e përgjithshëm, merr pjesë me 60%, kurse pikët e fituara nga shkrimi i esesë marrin pjesë me 40%.
Suksesi i arritur do të shprehet me përqindje, i rrumbullakuar në dy dhjetëshe.

P. sh. nëse nxënësi me zgjidhjen e detyrave të pjesës së parë të provimit fiton 17 nga 32 pikë të mundshme ose 12 nga 25 pikë të mundshme në hartimin e esesë, rezultati i tij përfundimtar llogaritet si në vazhdim:

$$\frac{60}{100}\cdot\frac{17}{32}+\frac{40}{100}\cdot\frac{12}{25}=0{,}3187+0{,}192=0{,}5107$$, d.m.th. 51,07%

## 4.3. Llojet e detyrave/pyetjeve

→ **detyrat/pyetjet e tipit të mbyllur**

- → detyrat/pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë
  (janë dhënë tri apo katër përgjigje prej të cilave njëra është e saktë; janë ofruar pesë ose gjashtë përgjigje nga të cilat dy ose tri janë të sakta; nxënësi rrethon numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen e bart në Fletën e përgjigjeve)

→ **detyrat/pyetjet e tipit të hapur**

- → detyrat/pyetjet e përgjigjes së shkurtër
  (duhet shkruar fjalën, sintagmën, fjalinë apo shpjeguar diçka në dy-tri fjali)
- → detyrat/pyetjet që kërkojnë përgjigje më të gjatë
  (hartimi i esesë)

**Shpërndarja e detyrave sipas llojit dhe fushave**

| Detyrat/pyetjet | Gjuhë | Letërsi | Të shprehurit me shkrim | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|
| Detyrat e tipit të mbyllur | 4 – 10 | 3 – 7 | – | 7 – 17 |
| Detyrat e tipit të hapur | 4 – 10 | 6 – 11 | 1 – 2 | 11 – 23 |
| **Gjithsej** | **8 – 20** | **9 – 18** | **1 – 2** | **18 – 40** |

Përmes detyrave/pyetjeve nxënësi duhet të tregojë

→ që e kupton përmbajtjen dhe qëllimin e tekstit joletrar/përmbajtjen dhe domethënien e tekstit letrar
→ që i njeh dhe i përdor nocionet letrare- historike dhe nocionet letrare- teorike
→ që di të analizojë tekstin (fragmentin ose fjalinë)
→ që ka njohuri të përgjithshme për gjuhën
→ që i njeh rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore

Me shkrimin e esesë nxënësi duhet të tregojë

→ që e kupton temën
→ që në bazë të udhëzimeve të dhëna di të shkruajë një punim që ka lidhshmëri dhe që është i qartë
→ që di të sqarojë përjetimet e veta
→ që di t'i argumentojë pohimet e veta
→ që di t'i përdorë shprehjet përkatëse
→ që di t'i zbatojë drejt rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore

# 5. PROGRAMI I PROVIMIT

**Ka të bëjë me fushat kryesore të cilat do të testohen:**

→ gjuhë
→ letërsi
→ të shprehurit me shkrim

## 5.1. GJUHË

***NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR GJUHËN***

Nxënësi/nxënësja duhet të dijë

→ të dallojë dhe të shfrytëzojë stilet funksionale, duke i lidhur me tekstet e caktuara: thirrja/letra formale (zyrtare), ligji, rregullorja, fletëfalënderimi, lutja, ankesa, konkursi, shpallja, letra publike, lajmi/raporti, teksti popullor- shkencor, artikulli shkencor, reportazhi, intervista, reklama, biografia/CV-ja si dhe teksti joartistik
→ që në bazë të tekstit të dhënë të caktojë autorin, temën, kujt i është kushtuar teksti; që në tekst të gjejë dhe të interpretojë të dhënat dhe lidhshmërinë e tyre; të dallojë dhe të formulojë temën dhe motivet e tekstit; të sqarojë domethënien e fjalëve të cituara nga teksti
→ çfarë është gjuha dhe cilat janë veçoritë dhe funksioni i saj
→ të njohë zhvillimin dhe llojet e alfabetit
→ të njohë klasifikimin gjenetik të gjuhës dhe familjen e gjuhës që i përket gjuha shqipe
→ të njohë shtresat e gjuhës (zhargonet dhe sociolektet, përdorimin dhe kuptimin e tyre)
→ që të dallojë dialektet e gjuhës shqipe, veçoritë dhe karakteristikat e tyre nga gjuha standarde

.

## GRAMATIKË

Nxënësi/nxënësja duhet

→ të njohë fonetikën e gjuhës shqipe, veçoritë dhe karakteristikat
1. ndryshimet fonetike
2. fonologjinë
3. ndarjen e tingujve
4. rrokjen
5. drejtshkrimin
6. drejtshqiptimin
7. prozodinë
8. theksin e fjalës

→ të zbatojë rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja J
→ të dallojë llojet e fjalëve dhe të dijë veçoritë e tyre morfologjike (domethënien, ndryshimet, kategoritë gramatikore)
→ të dallojë llojet e fjalive dhe të sqarojë funksionin e tyre në tekst (fjalitë e varura, të pavarura, aktive, pasive, jo të plota, të papërcaktuara)
→ të zbatojë rregullat e kongruencës (përputhshmërisë)
→ të përdorë drejt sistemin e rasave në të folur dhe në të shkruar
→ të dijë foljen: kohët, mënyrat, vetat, zgjedhimet
→ të ketë njohuri themelore nga leksikologjia e gjuhës shqipe, të dijë veçoritë dhe karakteristikat
→ të përdorë drejt frazeologjizmat dhe të shpjegojë domethënien e tyre

**DREJTSHKRIM**

Nxënësi/nxënësja duhet

→ të përdorë drejt shkronjën e madhe
→ të shkruajë drejt shkurtesat – të zbatojë rregullat për shkurtimin e fjalëve dhe shprehjeve
→ të shkruajë drejt gjuhën standarde
→ të zbatojë rregullat për shkrimin e fjalëve bashkë dhe ndaras
→ të ndajë drejt fjalët në fund të rreshtit
→ që në pajtim me rregullat (dhe udhëzimet drejtshkrimore) të përdorë shenjat e pikësimit
→ t'i shqipërojë drejt fjalët të cilat kanë një përdorim të shpeshtë

## 5.2. LETËRSI

Nxënësi duhet të dijë

→ që në një tekst të dhënë t'i dallojë llojet, gjinitë letrare (lirikën, epikën, dramatikën) dhe llojet e letërsisë.
→ që t'i njohë periudhat letrare nga antika deri te letërsia bashkëkohore (përfaqësuesit kryesorë dhe veçoritë stilistike), të bëjë dallimin e veçorive stilistike të periudhave letrare.
→ që t'i njohë dhe t'i formulojë temën dhe motivet e tekstit; ta shpjegojë rëndësinë e fjalëve të cituara nga teksti
→ që t'i vërejë vetitë e hapësirës poetike (fiktive) dhe kohës e mënyrës në të cilën paraqiten ato, ta kuptojë nocionin
→ që t'i veçojë figurat stilistike në tekst (krahasimin, epitetin, simbolin, hiperbolën, anaforën, epiforën, refrenin, metaforën, metoniminë, eufemizmin, alegorinë, asindetin, polisindetin, ironinë) dhe ta shpjegojë përdorimin e tyre.
→ që organizimin kompozicional të këngës ta sjell në lidhje me kuptimin e saj (efektet e përsëritjes, renditjen e figurave poetike)
→ që t'i njohë elementet e vargëzimit (trokeun, jambin, daktilin) cezurën, rimën.
→ që t'i dallojë nocionet: autori, narratori, subjekti lirik, sistemin e personazheve (personazhin kryesor, personazhin dytësor, personazhin episodik)
→ që t'i dallojë termet personazhi dhe personaliteti, ta kuptojë nocionin e motivimit në ndërtimin e personazhit letrar, ta përshkruaj personazhin nga vepra (portretin e jashtëm dhe të brendshëm, motivimin social dhe psikologjik...)
→ që t'i njohë dhe t'i dallojë nocionet: përmbajtja, fabula, syzheu, episodi dramatik, digresioni.
→ që të dallojë format e rrëfimit dhe tipat e narratorit (forma Er/në vetën e tretë dhe Ich/në vetën e parë, narratori i besueshëm dhe i pabesueshëm)
→ që t'i njohë dhe t'i kuptojë karakteristikat e këngës epike dhe të epit (dhjetërrokëshin, heksametrin)
→ që të caktojë këndvështrimin (e brendshëm, të jashtëm) dhe të shpjegojë ndërrimin e tyre
→ që ta njohë natyrën e poezisë (sipas motiveve: atdhetar, shoqëror, filozofik, erotik, përshkrues dhe sipas llojit: vargu i lire, soneti, elegjia, himni)
→ që ta njohë natyrën e prozës (llojet: skica, tregimi, novela, romani)
→ që ta njohë natyrën e tekstit dramatik, tekstin didaskalik, monologun, dialogun, njësinë e veprimit të dramës dhe etapat e zhvillimit të ngjarjes.
→ që ta njohë antidramën dhe gjuhën e saj skenike
→ që të njohë karakteristikat e dramës antike dhe të dijë të shpjegojë nocionin e katarzës

## 5.3. TË SHPREHURIT ME SHKRIM

Nxënësi/Nxënësja duhet të dijë të shkruajë tekstin e llojit në vijim:
→ fletëfalenderimin, lutjen, ankesën, letrën zyrtare/jozyrtare, urimin, shpalljen, konkursin, raportin, lajmin, intervistën, reportazhin, rezymenë, përkujtuesin, shënimin, shqyrtimin, esenë.

***SHKRIMI I TEKSTIT FUNKSIONAL***

Nxënësi/nxënësja duhet
- → të respektojë udhëzimet për shkrimin e tekstit, formën e tekstit dhe parimet e formimit (hyrja, zhvillimi, përfundimi, paragrafët, shkrimi i emrit të vendit dhe datës, adresës, mënyra si të drejtohet, emri dhe mbiemri i dërguesit dhe marrësit, margjinat...)
- → të ketë kujdes për kuptimin, lidhshmërinë dhe rrumbullakimin e tekstit
- → të dallojë dhe të zbatojë stilet e ndryshme funksionale në të shkruar
- → që të zbatojë normën drejtshkrimore dhe gramatikore

***SHKRIMI I ESESË (INTERPRETUES OSE ANALITIK)***

Nxënësi/nxënësja duke respektuar udhëzimet duhet
- → që i/e pavarur të shkruajë esenë (tekstin e strukturuar – hyrja, shtjellimi, përfundimi, paragrafët) dhe mendimet e veta t'i mbështesë me argumente të vlefshme
- → që duke shfrytëzuar njohuri nga teoria e letërsisë të shprehë si i kupton vetë tekstet letrare të lexuara
- → që të zbatojë normën drejtshkrimore dhe gramatikore

## 5.4. VEPRAT LETRARE TË DETYRUESHME

**I**

*Epi i Gilgameshit (fragment)*
**Sofokliu:** *„Antigona"*
**Dante:** *„Ferri" (fragment)*
**Pjetër Bogdani:** *„Sibilat"*
**M. Barleti:** *„Historia e Skënderbeut" (fragment)*

**II**

**A. S. Pushkini:** *„Eugjen Onjegini" (fragment)*
**O. D. Balzak:** *„Xha Gorio"*
**Heminguej:** *„Plaku dhe deti"*
**J. de Rada:** *„Këngët e Milosaos" (fragment)*
**N. Frashëri:** *„Bagëti e Bujqësia"*
**P. P. Njegosh:** *„Kurora e maleve" (fragment)*

**III**

**Sharl Bodleri:** *„Albatrosi"*
**G. Flober:** *„Zonja Bovari" (fragment)*
**Lasgush Poradeci:** *„Vdekja e Nositit"*
**Faik Konica:** *„Doktor gjilpëra"*
**N. Mjeda:** *„Liria"*
**Ali Podrimja:** *„Drejtpeshimi"*

**IV**

**A. Kamy:** *„I huaji" (fragment)*
**G. Markes:** *„Kolonelit s' ka kush t'i shkruajë" (fragment)*
**U. Shekspiri:** *„Hamleti"*
**Gj. Fishta:** *„Lahuta e Malcisë"*
**I. Kadare:** *„Gjenerali i ushtrisë së vdekur"*
**F. Kongoli:** *„Ëndrra e Damokleut" (fragment)*
**A.Pashku:** *„Sinkopa"*

***Vërejtje:*** *Në rast se testi përmban fragmente nga veprat letrare të cilat nuk janë në regjistër të veprave letrare të detyrueshme, pyetjet kanë të bëjnë vetëm me atë fragment dhe nuk nënkuptojnë që vepra është lexuar.*

## 6. SHEMBULLI I TESTIT

**Lexo tekstin dhe pastaj zhvillo detyrat 1, 2, 3, 4 dhe 5.**

Forum MNE

FILOZOFSKI FAKULTET
Nikšić

Forumi MNE dhe Fakulteti Filozofik, Universiteti i Malit të Zi, Nikshiq, Ju ftojnë që të paraqiteni në kursin universitar:

# "LIDERIZMI DHE PUNA RINORE NË BASHKËSI"

Programi përbëhet nga 7 blloqe të ligjëratave (21 ECTS) dhe punës praktike (9 ECTS).

1. Hyrje në punën rinore në bashkësi dhe zhvillimi personal
2. Periudha e jetës së adoleshencës
3. Hulumtimi në punën rinore në bashkësi
4. Puna me grupe
5. Avancimi i shkathtësive komunikuese në kontekst të punës me individë
6. Puna në konflikte dhe pranimi i dallimeve
7. Menaxhmenti projektues në punën rinore në bashkësi, politika rinore
8. Puna praktike (hulumtimi nevojë e të rinjve në bashkësi dhe 10 punëtori të zhvillimit me të rinj)

Të gjitha informatat e nevojshme për kursin dhe formularët për paraqitje mund t'i fitoni, kurse të plotësuarit dorëzoni në:

- web site/n e Forumit MNE: www.forum-mne.com
- përmes E-mail/it: sandra.smolovic'forum-mne.com
- në adresë: Bratstvo - jedinstvo 4: 81000 Podgorica: 020/602-710

Afati i fundit për dërgimin/paraqitjen e fletëparaqitjes është 20 shtatori, deri në orën 17. Fletëparaqitjet e dërguara me vonesë nuk do të merren parasysh. Të gjithë kandidatët/et do të lajmërohen për rezultatet e përzgjedhjes.

Programi zbatohet me mbështetjen e:

mailto:edu.ulqin@cg.yu

forum syd

Sida

**1. Cili është qëllimi i këtij teksti?**

A. Që të informojë opinionin për projektin e rifilluar „Liderizmi dhe puna rinore në bashkësi".
B. Që të ftojë të interesuarit që të paraqiten në kursin e universitetit „Liderizmi dhe puna rinore në bashkësi".
C. Instruksion për të punësuarit në Universitetin e Malit të Zi për shtatë blloqet e reja të ligjëratave dhe punën praktike.
D. Udhëzim për opinionin për punën e Forumit MNE, të Fakultetit Filozofik në Nikshiq dhe Universitetin e Malit të Zi.

***Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën e përgjigjeve.***

*(1 pikë)*

**2. Çka përfshin puna praktike në kuadër të „Liderizmit dhe punës rinore në bashkësi"?**

..........................................................................................................................................................

*(1 pikë)*

**3. Fjalët me prejardhje të huaj në tekstin që ke lexuar më sipër shkruaji në pajtim me fonetikën e gjuhës shqipe. (Transkriptoji ato).**

..........................................................................................................................................................

*(1 pikë)*

**4. Rrethoje shkronjën para pohimit të saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën e përgjigjeve.**

A. Programi përfshin pjesën teorike dhe punën praktike.
B. Formularët e paraqitjes mund t'i fitoni, kurse të plotësuarit mund t'i dorëzoni në e-mail: mailto: edu.ulqin@cg.yu
C. Kandidatët që do të pranohen do të lajmërohen për rezultatet e përzgjedhjes.

*(1 pikë)*

**5. Për fjalët e prejardhjes së huaj shkruaj nga një domethënie në gjuhën shqipe.**

liderizmi ..................................................................................

konteksti ..................................................................................

*(2 pikë)*

**Lexo tekstin 1 dhe tekstin 2 e pastaj zhvillo detyrat 6, 7 dhe 8.**

**Teksti 1**

**Lektor,** ~ i m. (lat. Lector-lexues, sipas legere lexoj), 1. njeri profesional i cili lexon një dorëshkrim, tekst, në fazën e përgatitjes për botim dhe përmirëson gabimet gjuhësore dhe stilistike. 2. mësimdhënës në universitet apo ndonjë institucion të ngjashëm i cili mban ushtrime zakonisht për një gjuhë të huaj; titulli (shkencor) i atij mësimdhënësi. 3. religj. në kishën e krishterë grada e ultë e klerikëve.

**Teksti 2**

**Alan Xh. Rou**

**Inteligjenca kreative**

**Zbuloni potencialet tuaja të reja dhe të tjerëve**

CLIO
Gospodar Jovanova 44
Beograd

*për botuesin*
Zoran Hamoviq

*recensente*
Mr. Svetllana Joviçiq

*lektore*
Sonja Shoq

*korrektore*
Ollga Kurjak-Paviqeviq
Lubica Naranççiq

*disenjator i librit*
Dragan Atanasoviq

*zgjidhja grafike e ballinave*
Svetllana Voliq

*redaktor teknik*
Darko Staniçiq

*botues*
Grafolik
Beograd

info@clio.co.yu
www.clio.co.yu

**6. Teksti 1 është përcaktues nga:**

A. fjalori i sinonimeve
B. fjalori frazeologjik
C. fjalori i fjalëve të huaja
D. fjalori i zhargoneve

***Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën e përgjigjeve.***

*(1 pikë)*

**7. Teksti 2 është:**

A. impresumi i librit "Inteligjenca kreative"
B. përcaktuesi i katalogut të librit "Inteligjenca kreative"
C. ballina e librit "Inteligjenca kreative"
D. përmbajtja e librit "Inteligjenca kreative"

***Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën e përgjigjeve.***

> ***Impresumi*** *(lat. Impressum – shtypur), të dhënat e detyrueshme me ligj për botuesin dhe bashkëpunëtorët që marrin pjesë në hartimin e një libri, për shtëpinë botuese...*

*(1 pikë)*

**8. Nga teksti 1 përshkruaj domethënien që i përgjigjet kuptimit të fjalës lektor nga teksti 2.**

.................................................................................................................................

.................................................................................................................................

.................................................................................................................................

*(1 pikë)*

**9.** KUR LËKURA FUTET NËN LËKURË

**Shpjego kuptimin e frazeologjisë nga titulli i dhënë gazetaresk.**

.................................................................................................................................

.................................................................................................................................

.................................................................................................................................

*(1 pikë)*

**10.**

*Krujë o qytet i bekuar*
*prite, prite Skënderbenë,*
*po vjen si pëllumb i shkruar*
*të shpëtojë mëmëdhenë.*

**Në katër vargjet e veçuara të "Historisë së Skënderbeut" Naimi në dy prej tyre përdor figurën stilistike të:**

A. simbolit
B. anaforës
C. epitetit

***Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën e përgjigjeve.***

*(1 pikë)*

**Lexo tekstin në vijim dhe përgjigju pyetjeve 11, 12, 13 dhe 14.**

*Ah, po të isha i pasur, po ta kisha ruajtur pasurinë time e të mos ua kisha dhënë, ato do të ishin këtu, do të më lanin faqet me të puthura! Do të banoja në një pallat, do të kisha dhoma të bukura, shërbëtorë, zjarr për t'u ngrohur dhe ato do të ishin këtu, me lot nëpër faqe, me gjithë burrat dhe fëmijët e tyre. Do t'i kisha të gjitha. Kurse tani s'kam asgjë! Paraja të jep gjithçka, edhe vajzat! Oh! Ku janë paratë e mia? Sikur të kisha thesare për të lënë, ato do të më rrinin te koka, s'do të dinin ç'të më bënin më parë, do t'u dëgjoja zënë, do t'i shikoja. Ah, biri im i dashur, djali im i vetëm, më mirë që mbeta i braktisur dhe në mjerim! Të paktën, kur e duan fatzinë, ai është i sigurt që e duan me gjithë shpirt. Jo, desha desha të isha i pasur; do t'i kisha parë! Për besë kushedi? Ato të dyja kanë zemër prej guri. Kaq e madhe ishte dashuria ime për to, sa që s'mbetej vend për dashurinë e tyre ndaj meje. Një atë, duhet të jetë gjithmonë i pasur, duhet t'i mbajë prej freri fëmijët e tij, si kuajt e hasdisur. Kurse unë rrija në gjunjë përpara tyre. Fatzezat! Po e kurorëzojnë denjësisht sjelljen që kanë treguar ndaj meje këto dhjetë vjetët e fundit.*

*Vdekja e Gorios (Fragment nga romani Xha Gorio - Honore de Balzak)*

**11. Mendimet e tij në këtë fragment, personazhi Xha Gorio i shfaq përmes:**

..............................................................................................................................

*(1 pikë)*

**12. Ne këtë fragment përmes personazhit të Xha Gorios, autori shfaq ndjenjën e:**

A. qetësisë së tij
B. dëshprimit të tij
C. pashpirtësisë së tij

***Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën e përgjigjeve.***

*(1 pikë)*

**13. Në këtë fragment, tema kryesore është:**

A. shkatërrimi i familjes
B. ngjarjet historike në Francë
C. tjetërsimi i njeriut

***Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën e përgjigjeve.***

*(1 pikë)*

**14. Në fragmentin e mësipërm disa herë janë përdorur fjalët <u>oh</u> dhe <u>ah</u>. Çfarë fjalësh janë ato sipas kategorisë leksiko-gramatikore?**

..............................................................................................................................

*(1 pikë)*

**15. Rretho shkronjën para shkurtesës së shkruar drejt nga fjala doktor dhe zgjidhjen kaloje në fletën e përgjigjeve.**

1. Dr
2. Dr.
3. Dok

*(1 pikë)*

**16. Nën pjesët e veçuara shkruaj titullin e veprës nga e cila është shkëputur ajo dhe autorin e saj.**

**1.**

*Prej kah fill xen rriba e Verit*
*e m' Vezuv t' veshun n' gjineshtra*
*Kur Kankazit e n' Shkamb të Doverit*
*Ku rri Albona e pjek gënjeshtra,*
*fis ma t' vjetër kund nuk ka*
*se asht ky fis n' za i Shqiptarit*
*në mes t' cilit punët e mëdha*
*për Europë xunë t' enden sparit.*
*Po, m' këto male e karpa tona*
*spari Zeusi njerztë i rysi*
*e me augure te Dodona*
*egërsinë ai ua përmbysi:*
*Këtu edhe sparit Orë e Zana*
*nisën valle me vallëzua*
*e n për vërrije e fusha t' gjana*
*Xu pegasi me lodrue.*

..............................................................................................................................................

**2.**

Vuk Mandushiq
*Më të bukur se zana e ka*
*mbushur s'i ka të tetëmbëdhjetat*
*zemrën gjallë ma ka rrëmbyer*

Princ Jankoja
*Për ç' gjë zemrën ty ta ka rrëmbyer?*

..............................................................................................................................................

**3.**

*Në mes të shtegëtisë së kësaj jete*
*u gjeta në një pyll krejt errësi,*
*se kishe humb unë rrugën e vërtetë*

*Si ish ta them sa kam vështirësi*
*ai i egri pyll, i ashpër pyll hata*
*sa ta mejtoj më kall frikë përsëri!*

*Veçse më e idhtë në qoftë vdekja paksa!*
*Po me tregue ç`të mirë kam gjetë n`atë anë,*
*do flas për sende tjera që kam pa.*

*Po kur te rranza e kodrës qeshë afrue,*
*atje ku merrte frund ajo luginë,*
*që me aq tmer në zemër m`kish trazue*

*Vështrova lart e pash se si në shpinë*
*po vishej krejt nga rrezet e planetit,*
*që në gjithë shtigjet njerëzve u prin.*

..........................................................................................................................................................

**4.** *Ti Shqipëri, më ep nderë, më ep emërin Shqipëtar"*
*Zemërën ti ma gatove plot me dëshirë dhe me zjarr.*
*Shqipëri! O mëma ime! Ndonëse jam i mërguar,*
*Dashurinë tënde kurrë, zemëra s'e ka harruar.*

..........................................................................................................................................................

**5.** *Nëno moj, vajto, merr malin,*
*Larot t'a përmbysnë djalin*
*Që me Ismail Qemalin*
*Ngriti flamur trimëror.*

..........................................................................................................................................................

*(1 pikë)*

**Lexoje poezinë dhe përgjigju pyetjeve.**

*Atdheu*

*O Atdhe! Më je i dashur sa më s' ka*
*Më je nënë, më je motër, më je vëlla.*
*Nga çka rrotull më i shtrenjti ti më je,*
*Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhe.*
*Ty për ditë të pat parë ime nënë*
*Dheu në fund atë e pati ngrënë*
*Numëruar t'i pat syri yt*
*Te ti lindi, te ti vdiq ajo pastaj*
*Ti ke parë gjysh –stërgjyshërit e mi,*
*Edhe eshtrat tretur ua ke parë ti*
*Nga ti, shpirt – o, ata kurrë s' qenë ndarë.*
*Pranë teje patën qeshur, patën qarë...*
*Begatoje, o imzot, ti këtë vend!*
*Epu njerëzve të tij ti mbroth e shend!*
*Hi u bëfshin gjithmon' armiqtë e tij!*
*I begatë i lulëzuar qoftë ai,*
*Një të ardhme pastë plot lumturi.*

*Naim Frashëri*

**17. Poezia e mësipërme trajton motivin** ..........................................................................................

*(1 pikë)*

**18. Në këtë poezi, poeti flet për:**

A. atdheun
B. dashurinë
C. ndjenjën ndaj natyrës

***Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën e përgjigjeve.***

*(1 pikë)*

**19. Në cilën mënyrë gramatikore janë foljet e fjalive të shënuara më poshtë?**

*Begatoje, o imzot, ti këtë vend!*
*Epu njerëzve të tij ti mbroth e shend!*

A. urdhërore
B. lidhore
C. dëshirore

***Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën e përgjigjeve.***

*(1 pikë)*

**20. Çfarë rime ka përdorur poeti në këtë poezi?**

..........................................................................................................................................................

*(1 pikë)*

**21. Në vargun e katërt të poezisë " Atdheu", mbiemri <u>më i miri</u>, është në shkallën:**

A. pohore
B. krahasore
C. sipërore

***Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën e përgjigjeve.***

*(1 pikë)*

**22. Përcakto epokën letrare (formacionin stilistik) që i takojnë këta shkrimtarë:**

Marin Barleti ......................................................................
Jeronim de Rada ......................................................................
Mitrush Kuteli ......................................................................

*(1 pikë)*

**23. Kur zanorja a ndërron në e kemi:**

A. apofoni
B. palatalizim
C. metafoni

***Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën e përgjigjeve.***

*(1 pikë)*

**24. Në ç' rasë është emri *incidentesh* në fjalinë:**

*"Në bazën e Vlorës, në principatën e Topiajve, te Dukagjinët dhe Kastriotët në veri, kudo turqit kanë shpërthyer një valë incidentesh"*

..............................................................................................................................

*(1 pikë)*

**25. Në ç' shkallë është mbiemri i përdorur në fjalinë:**

*"Ai u zhvillua brenda një kohe tepër të shkurtër..."*

..............................................................................................................................

*(1 pikë)*

**26. Kush është përgjegjës për hartimin e maketës dhe rregullimin e sheshit (skenës) për pamjen teatrale?**

A. skenografi
B. tekniku i dritave
C. rekuiziteri

***Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën e përgjigjeve.***

*(1 pikë)*

**Me kujdes lexo fragmentin nga vepra e Kadaresë "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" dhe përgjigju në pyetjet 27, 28 dhe 29.**

*Gjeneralit i ra pija në kokë. Unë kam tani një ushtri të tërë të vdekurish, mendoni. Vetëm se ata tani, në vend të uniformës, kanë secili nga një thes najloni. Thasë të kaltër me dy vija të bardha dhe një shirit të zi, prodhim special "Olympias". Në fillim ishin ca skuadra. Pastaj u krijuan kompanitë, pastaj batalionet dhe tani po plotësohen divizionet dhe regjimentet. Një ushtri e tërë e mbështjellë me najlon.*

*(Pjesë nga vepra e I. Kadaresë)*

**27. Cilit lloj letrar i takon vepra"Gjenerali i ushtrisë së vdekur"?**

.............................................................................................................................................................................

*(1 pikë)*

**28.** **Me një fjali shkruaj për çka bëhet fjalë në fragmentin e mësipërm të veprës së shkrimtarit tonë të njohur.**

..............................................................................................................................................................

..............................................................................................................................................................

..............................................................................................................................................................

*(1 pikë)*

**29.** **Kush janë personazhet kryesore të kësaj vepre të Kadaresë?**

..............................................................................................................................................................

*(1 pikë)*

**30.** **Janë dhënë dy tema për hartimin e esesë. Retho numrin para temës të cilën e ke zgjedhur dhe shkruaje esenë që duhet të ketë 250-300 fjalë. Hartoje atë si tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin. Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/- 10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë ajo NUK LEXOHET FARE, kurse në fjalën e 330–të NDËRPRITET leximi).**
**Kij kujdes që në aspektin gjuhësor fjalia të jetë e qartë, e kuptueshme dhe të mos ketë gabime gjuhësore.**

**1.** **Lexo me kujdes fragmentin nga vepra „Poema e mjerimit" të Migjenit dhe sqarimet për të shkruar esenë letrare me titullin „Si realizohet portreti i mjerimit në këtë poemë".**

## Këshilla për shkrimin e esesë:

**1. Pjesa hyrëse**

Përcakto
→ Cilit drejtim i takon krijimtaria e Migjenit?
→ Cilës formë letrare i takon „Poema e mjerimit"?
→ Pse Migjeni me vetëdije përmend vetëm gjendjen e mjeruar?

**2. Pjesa kryesore**

→ Sqaro se çka kritikon poeti në „Poemën e mjerimit"?
→ Cila është thirrja e poemës dhe me cilat vargje përshkruhet mjerimi dhe revolta kundër gjendjes sociale (konkretizo me shembuj)?
→ Shpjego arsyet e dominimit të temës së mjerimit, revoltës, fatit të njeriut, bëje përshkrimin e mjerimit dhe jep si ilustrim vargje nga poema.
→ Analizo gjuhën të cilën poeti përdor në „Poemën e mjerimit".

**3. Përfundimi**

→ Përmbylle esenë letrare me shprehjen e mendimeve për platformën letrare të Migjenit dhe prirjet sociale tek autorët e tjerë shqiptarë.

**Fragmenti i „Poemës së mjerimit", nga Migjeni**

*POEMA E MJERIMIT*

*Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi,*
*kafshatë që të mbetë në fyt edhe të ze trishtimi*
*kur she ftyra të zbeta edhe sy të jeshilta*
*që të shikojnë si hije dhe shtrijnë duert e mpita*
*edhe ashtu të shtrime mbrapa teje mbesin*
*të tanë jetën e vet derisa të vdesin.*
*E mbi ta n'ajri, si në qesendi,*
*therin qiellën kryqat e minaret e ngurta,*
*profetënt dhe shejtënt në fushqeta të shumngjyrta*
*shkëlqejnë. E mjerimi mirfilli ndien tradhti.*
*Mjerimi ka vulën e vet të shëmtueme;*
*asht e neveritshme, e keqe, e turpshme;*
*balli që e ka, syt që e shprehin,*
*buzët që më kot mundohen ta mshefin -*
*janë fëmitë e padijes e flitë e përbuzjes,*
*të mbetunat e fliqta rreth e përqark tryezës*
*mbi të cilën hangri darkën një qen e pamshirshëm*
*me bark shekulluer, gjithmon i pangishëm.*
*Mjerimi s'ka fat. Por ka vetëm zhele,*
*zhele fund e maje, flamujt e një shprese*
*të shkymë dhe të coptuem me të dalun bese.*
*Mjerimi tërbohet në dashuni epshore.*
*Nëpër skaje t'errta, bashkë me qej, mij, mica,*
*mbi pecat e mykta, të qelbta, të ndyta, të lagta*
*lakuriqen mishnat, si zhangë; të verdhë e pisa;*
*kapërthehen ndjenjat me fuqi shtazore,*
*kafshojnë, përpijnë, thithen, puthen buzët e ndragta*
*edhe shuhet uja, dhe fashitet etja*
*n'epshin kapërthyes, kur mbytet vetvetja.*
*Dhe aty zajnë fillin të marrët, shërbtorët dhe lypsat*
*që nesër do linden me na i mbushë rrugat.*
*Mjerimi në dritzën e synit te kërthini*
*dridhet posi flaka e mekun qirini*
*nën tavan të tymuem dhe plot merimanga,*
*ku hije njerzish dridhen ndër mure plot danga,*
*ku foshnja e smueme qan si shpirt' i keq*
*tu' ndukë gjitë e shterruna të së zezës amë,*
*e kjo prap shtazanë, mallkon zot e dreq,*
*mallkon frytn e vet, mallkon barrn e randë.*
*Foshnj' e saj nuk qesh, por vetëm lëngon,*
*e ama s'e don, por vetëm mallkon.*
*Vall sa i trishtueshëm asht djepi i skamit*
*ku foshnjën përkundin lott edhe të fshamit!*
*Mjerimi rrit fënnin në hijen e shtëpive*
*të nalta, ku nuk mrrin zani i lypsis,*
*ku nuk mund t'u prishet qetsia zotnive*
*kur bashkë me zoja flejnë në shtretënt e lumnis.*
*Mjerimi pjek fëmin para se të burrnohet;*
*don ta msojë t'i iki grushtit q'i kërcnohet,*
*atij grusht që në gjumë e shtërngon për fytit*
*kur fillojnë kllapitë e etheve prej unit*
*dhe fetyrën e fëmis e mblon hij'e vdekjes,*

*një stoli e kobshme në vend të buzqeshjes.*
*Një fryt kurse piqet dihet se ku shkon*
*qashtu edhe fëmia në bark të dheut mbaron.*

*(25 pikë)*

**2. Lexo me vëmendje fragmentin "Rozi Blo" nga artikulli i shpallur në Financial Times i cili flet për programet e softuerëve të cilët(nuk)nxisin shkrimin kreativ, si dhe udhëzimin për shkrimin e esesë "Shkurt deri te romani me ndihmë të kompjuterit".**

### Këshilla për shkrimin e esesë:

1. Përshkruaj çdo qëndrim tëndin për nxitjen kompjuterike të kreativitetit në letërsinë e bukur
2. Komento qëndrimin e Di Gordonit dhe Xhorxh Grinit dhe krahasoj qëndrimet e tyre.
3. A pajtohesh me qëndrimin e Megi Bodenit? Argumento.

LETËRSIA KOMPJUTERIKE

## SHKURT DERI TE ROMANI

*Shkencëtarët kanë zhvilluar shumë programe të softuerit që ju mësojnë se si të shkruani. Ata ju ofrojnë modelin se si ta lironi kreativitetin tuaj dhe Brenda një afati të shkurtër të shkruani një roman.*

Përkundër rritjes së valës së romaneve që pothuaj nuk vlejnë asgjë, mund të themi lirisht se jetojmë në botën e shkrimtarëve fillestar ambicioz. Kështu në vitin 2001, në një anketë të zhvilluar për shtëpinë britanike të librarisë V. H. Smit, është vërtetuar se 50% e banorëve të Britanisë së Madhe dëshiron të shkruajnë një vepër.

Është paraqitur industria globale e shkrimeve në mënyrë që t'ua plotësojë atë dëshirë: në vitin 1970 romansierët Malkolm Bredberi dhe Agnus Vilson kanë themeluar kursin e pas diplomimit të ashtuquajtur kurs i shkrimit kreativ në Universitetin e Anglisë Lindore. Sot më tepër se 80 universitete britanike ofrojnë kurse të tilla, kurse libri "Një roman për një vit", i autores Luiz Dauti, një nga doracakët më të njohur që u kushtohet shkrimtarëve potencial, vetëm gjatë këtij viti është shitur në 4000 kopje.(...)

Shoqëria bashkëkohore është e mbushur me produkte që ofrojnë rrugë të shkurtër për gjithçka, prej mirëkuptimit të teorisë së relativitetit, pastaj përvetësimit të të gjitha sekreteve të gjuhës frënge për një javë, deri te arritja e trupit të përkryer. Prandaj rruga e shkurtër deri te shkrimi i letërsisë së bukur është hap logjik. „Të jemi të sinqertë, koha është para. Shkruani një vepër, e keni kohën, siç ka ndodhur, dje, atëherë është normale që të kërkoni një mjet të tillë", pohojnë krijuesit e programit NewNovelist, të cilët konstatojnë se programi i tyre është udhëheqës në tregun britanik të prodhimeve të softuerit të shkrimeve; prej vitit 2001 kur programi është lëshuar në qarkullim, deri më sot janë shitur më se 100 000 ekzemplarë. Për 29.99 sterlina ai program ju premton se do ta "lirojë kreativitetin e mbyllur i cili ekziston te çdonjëri prej nesh".

Programi i softuerit NewNovelist në të cilin theksi është në strukturën narrative ka dhjetë linja të mundshme të rrëfimit në kategorinë e vet të „fabulës", nëntë mundësi për „aspektin epik" dhe dy për vepra në të cilat vendi kryesor do t'u takonte personazheve letrare. Diapazoni është mjaft i gjerë dhe lëviz nga "aventura e aksionit", "hakmarrja", përmes tregimeve "mbinatyrore", e deri te "pjekuria" apo "tregimi i dashurisë"... (...)

Di Gordon në vitin 2004 ka botuar botimin autorial të romanit të parë të saj

“Tregu i mishit”, në të cilin ka përshkruar dy ditë të jetës së një agjencie për punësim. Pastaj e ka blerë programin NewNovelist në mënyrë që të fillonte punën në romanin e dytë: „Mendova se kjo është një ide e jashtëzakonshme, një ide e shkëlqyer. E pastaj, kur jam thelluar në shkrim, e kam kuptuar se me atë softuer vetëm po humbisja kohë.“

Sidoqoftë, disa autorë të tjerë ky program i ka nxitur të shkruajnë. Xhorxh Grin ligjëron shkrim kreativ në Universitetin e Lankesterit. Ai thotë se 30 vjet ka punuar në romanin e parë të tij “Qeni gjurmues”, të cilin në vitin 2003 e ka botuar shtëpia botuese Bantam. Për romanin e dytë, “Fajkoi” Grinit i janë nevojitur gjithsej 18 muaj – këtë shpejtësi Grini ia vesh faktit se e ka shfrytëzuar NewNovelistin.

Megjithatë, vërtetë a mundet kompjuteri ta nxisë kreativitetin?

Nuk mundet, konsideron Megi Boden, profesoreshë e psikologjisë kognitive në Universitetin Saseks. Sipas fjalëve të saj, programi kompjuterik „askurrë nuk mund t’i simulojë të gjitha ato gjykime dhe shqyrtime që i dallon puna e çdo shkrimtari, të paktën qoftë ai edhe mediokritet i konsiderueshëm“.

„Kjo nuk do t’ju transformojë në Xheki Kolins, e lëre më në Marsel Prustin“, shton profesoresha Boden. (...)

*(Rozi Blo, Financial Times)*

**Në fletët e parapara për shkrimin e esesë mund të shkruash planin/konceptin e esesë, e pastaj esenë përshkruaje qartë.**

*(25 pikë)*

.....................................................................................................................................

.....................................................................................................................................

.....................................................................................................................................

.....................................................................................................................................

.....................................................................................................................................

.....................................................................................................................................

.....................................................................................................................................

.....................................................................................................................................

.....................................................................................................................................

.....................................................................................................................................

.....................................................................................................................................

.....................................................................................................................................

.....................................................................................................................................

.....................................................................................................................................

.....................................................................................................................................

.....................................................................................................................................

.....................................................................................................................................

# 7. FLETA E PËRGJIGJEVE

Nxënësit bashkë me testin do të fitojnë edhe Fletën për shënimin e përgjigjeve në detyrat me zgjidhje të shumëfishtë. Është e nevojshme që në vendin e duhur **ME KUJDES** t'i përshkruajnë përgjigjet e tyre.

qendra e provimeve

PROVIMI I MATURËS

**FLETA E PËRGJIGJEVE**

Gjuhë shqipe dhe letërsi

Shifra e nxënësit

Shëno kështu: ☒

1. A. ☐ B. ☐ C. ☐ D. ☐

4. A. ☐ B. ☐ C. ☐

6. A. ☐ B. ☐ C. ☐ D. ☐

7. A. ☐ B. ☐ C. ☐ D. ☐

10. A. ☐ B. ☐ C. ☐

12. A. ☐ B. ☐ C. ☐

13. A. ☐ B. ☐ C. ☐

15. A. ☐ B. ☐ C. ☐

18. A. ☐ B. ☐ C. ☐

19. A. ☐ B. ☐ C. ☐

21. A. ☐ B. ☐ C. ☐

23. A. ☐ B. ☐ C. ☐

26. A. ☐ B. ☐ C. ☐

**Shembulli i fletës me shënimin e saktë të përgjigjeve të nxënësve**



qendra e provimeve

PROVIMI I MATURËS

**FLETA E PËRGJIGJEVE**

Gjuhë shqipe dhe letërsi

Shifra e nxënësit

Shëno kështu: ☒

| | A. | B. | C. | D. |
|---|---|---|---|---|
| 1. | ☐ | ☒ | ☐ | ☐ |
| 4. | ☒ | ☐ | ☐ | |
| 6. | ☐ | ☐ | ☒ | ☐ |
| 7. | ☒ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 10. | ☐ | ☐ | ☒ | |
| 12. | ☐ | ☒ | ☐ | |
| 13. | ☒ | ☐ | ☐ | |
| 15. | ☐ | ☒ | ☐ | |
| 18. | ☒ | ☐ | ☐ | |
| 19. | ☒ | ☐ | ☐ | |
| 21. | ☐ | ☐ | ☒ | |
| 23. | ☐ | ☐ | ☒ | |
| 26. | ☐ | ☐ | ☒ | |

# 8. ZGJIDHJA E TESTIT ME SKEMË PËR VLERËSIM

**1.**
B.
*1 pikë*
**2.**
Hulumtimi nevojë e të rinjve në bashkësi dhe 10 punëtori të zhvillimit me të rinj./
Hulumtimi nevojë e të rinjve në bashkësi.
*1 pikë*
**3.**
web site; E-mail/web site; E-mail/Web site; e-mail/Web site; e-mail; www;
com/web site (veb sajt); E-mail (i-mejll/mejll)
*1 pikë*
**4.**
A.
*1 pikë*
**5.**
Udhëheqje;
Mjedisi/Lidhshmëria/Përcaktimi i kuptimit të fjalëve në bazë të fjalisë ku ndodhet ajo fjalë apo në bazë të një pjese të shkëputur. *(dhe përgjigje të ngjashme)*
*Numri maksimal i pikëve: 2*
Nxënësi e ka shpjeguar domethënien e vetëm një fjale të kërkuar.
*Numri i pjesshëm i pikëve: 1*
Tregon kuptim të gabuar OSE jep përgjigje të pamjaftueshme APO përgjigje të pacaktuar.
*0 pikë*
**6.**
C.
*1 pikë*
**7.**
A.
*1 pikë*
**8.**
1. njeri profesional i cili lexon një dorëshkrim, tekst, në faze e përgatitjes për botim dhe përmirëson gabimet gjuhësore dhe stilistike./Shpjegimi nën numrin 1.
*1 pikë*
**9.**
Kur lëkura për ndokënd bëhet pasion./Kur bërja e gjërave nga lëkura për ndokënd bëhet pasion./Kur qepja e rrobave nga lëkura për ndokënd bëhet punë e dashur *(dhe përgjigje të ngjashme)*.
*1 pikë*
**10.**
C.
*1 pikë*
**11.**
Përmes monologut
1 pikë
**12.**
B.
*1 pikë*
**13.**
A.
1 pikë
**14.**
Pasthirrma
*1 pikë*
**15.**
B.
1 pikë

**16.**
1. Gjergj Fishta, "Lahuta e Malcisë"
2. P.P.Njegosh, "Kurora e maleve"
3. Dante, "Ferri"
4. N.Frashëri, "Bagëti e Bujqësia"
5. F. Noli, "Syrgjyn vdekur"
1 pikë
**17.**
Patriotik (atdhetar)
1 pikë
**18.**
A.
1 pikë
**19.**
A.
1 pikë
**20.**
Rimë të puthitur
1 pikë
**21.**
C.
1 pikë
**22.**
M.Barleti-Humanizmi
J.d.Rada-Rilindja
M.Kuteli-Realizmi
1 pikë
**23.**
C.
1 pikë
**24.**
Rasa rrjedhore
1 pikë
**25.**
Në shkallën sipërore(absolute)
1 pikë
**26.**
A.
1 pikë
**27.**
Roman (prozë)
1 pikë
**28.**
Bëhet fjalë për ushtrinë e cila erdhi okupatore dhe u kthye e vdekur në najlon. Kemi të bëjmë me trimërinë shqiptare.
1 pikë.
**29.**
Gjenerali, prifti, plaka Nicë.
1 pikë

**30.**
Skema për vlerësimin e esesë
**25 pikë**
**Përmbajtja-14 pikë**

| | |
|---|---|
| **kërkesa e parë** | **Nxënësi tregon për:**<br>→ letërsinë shqiptare ndërmjet dy luftërave botërore së cilës i takon krijimtaria e Migjenit(1 pikë)<br>→ vendin e "Poemës së mjerimit" në letërsinë e viteve 30 por edhe në letërsinë shqipe në përgjithësi (1 pikë)<br>→ poemën si pasqyrë e realitetit të hidhur shqiptar të asaj kohe (1 pikë)<br>**gjithsej 3 pikë** |
| **kërkesa e dytë** | **Nxënësi**<br>→ tregon se çka përshkruan poeti në "Poemën e mjerimit" (1 pikë)<br>→ tregon për burimin e mllefit mbi fatin njerëzor, mbi absurdin e tragjikomedinë e jetës (1 pikë)<br>→ tregon se cila është thirrja e poemës (citon vargun gjegjës) dhe jep shembuj vargjesh ku Migjeni tregon mjerimin e shqiptarit të rëndomtë (1 pikë)<br>→ tregon për jetën njerëzore dhe atë shqiptare të cilat ndërthuren duke i dhënë krijimtarisë së Migjenit nota të dukshme universaliteti (1 pikë)<br>→ perifrazon apo citon nga poema shqetësimin e poetit për mjerimin i cili ka kapluar shqiptarin e asaj kohe (1 pikë)<br>**gjithsej 5 pikë** |
| **kërkesa e tretë** | **Nxënësi**<br>→ tregon arsyet e dominimit të temës së mjerimit në poemën e jetës reale (1 pikë)<br>→ rrëfen për përshkrimin që i bën skamjes dhe protagonistëve të saj Migjeni (1 pikë)<br>→ tregon për heronjtë e "Poemës së mjerimit" (1 pikë)<br>**gjithsej 3 pikë** |
| **kërkesa e katërt** | **Nxënësi**<br>→ *nxënësi tregon edhe për dukuri të tjera me karakter shoqëror në "Poemën e mjerimit", citon vargje me motive në fjalë (1 pikë)*<br>→ *tregon për gjuhën e Migjenit në "Poemën e mjerimit", posaçërisht duke u ndalur në përdorimin e dialektit (1 pikë)*<br>→ *jep dëshmi bindëse për pikëpamjet letrare të Migjenit vepra e të cilit shënoi kalimin nga letërsia me nota të dukshme romantike në një krijimtari që bën protagonist realitetin me problemet e shumta të tij (1 pikë)*<br>**gjithsej 3 pikë** |

**Struktura gjuhësore dhe ndërtimore e tekstit - 11 pikë**

| Leksiku | Drejtshkrimi | Lidhshmëria | Struktura ndërtimore e tekstit |
|---|---|---|---|
| → Vlerësohet origjina-liteti i shprehjes gjatë hartimit të esesë, pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, me gabime minimale.<br><br>**Gjithsej 3 pikë** | → rrespektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore (koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve **për** dhe **mbi**, përemrit **i vet/i tij**, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: **lidhur me këtë**, **duke marrë parasysh** dhe i përemrave: **që, i cili, e cila, të cilët** etj., përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale.<br>**2 pikë**<br>→respektimi i normës drejtshkrimore ( shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave **r/rr, dh/ll, k/q, s/z, k/g, ç/q, gj/xh, e/ë**, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores **ë**, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja **j**<br><br>**2 pikë**<br>**Gjithsej 4 pikë** | → lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve<br><br>**2 pikë** | → lidhja e mirë e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin)<br><br>**2 pikë** |

| Leksiku | Drejtshkrimi | Lidhshmëria | Struktura ndërtimore e tekstit |
|---|---|---|---|
| - përsëritja e fjalëve dhe shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta<br>**2 pikë** | →respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve **për** dhe **mbi**, përemrit **i vet/i tij**, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit **lidhur me këtë, duke marrë parasysh** dhe i përemrave: **që, i cili, e cila, të cilë**t etj.<br>**1 pikë**<br>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta (p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores **ë**, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja **j**<br>**1 pikë**<br>**Gjithsej 2 pikë** | - lidhshmëria e mirë në nivel të tekstit me palidhshmëri të përkohshme në nivel të paragrafëve<br>**1 pikë** | - palidhshmëria e përkohshme e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike të tij (nuk ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin)<br>**1 pikë** |
| - përsëritja e fjalëve dhe shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta<br>**1 pikë** | | | |

Skema për vlerësimin e esesë 2.
**25 pikë**
**Përmbajtja – 14 pikë**

| | |
|---|---|
| **kërkesa e parë** | **Nxënësi:**<br>→ në hyrje flet për shkrimin kreativ/letërsinë e bukur/teknologjinë Bashkëkohore (1 pikë), dhe përshkruan programin e softuerit NewNovelist (1 pikë + 1 pikë për shpjegim të plotë – p.sh. 10 mundësi të rrëfimit, 9 mundësi të zhvillimit të veprimit epik, 2 mundës të ndërtimit të personazheve, të temës së mundshme)<br>**gjithsej 3 pikë** |
| **kërkesa e dytë** | **Nxënësi komenton qëndrimin e zonjës Di Gordon dhe zotëri Xhorxh Grinit:**<br>→ Di Gordon ka tentuar të zbatojë përparësitë e kompjuterit në shkrimin kreativ dhe vendos të shfrytëzojë programin e softuerit (1 pikë), por është e zhgënjyer sepse e kupton se humb kohë. (1 pikë)<br>→ Xhorxh Grin kupton përparësitë e shfrytëzimit të programit të softuerit dhe e zbaton në shkrim të romanit të dytë (1 pikë), kurse shpejtësinë e krijimit të tij ia vesh programit të softuerit. (1 pikë)<br><br>**Nxënësi krahason qëndrimin e zonjës Di Gordon dhe zotëri Xhorxh Grinit:**<br>→ Di Gordon dhe Xhorxh Grin janë dy njerëz të cilët i hetojnë për-parësitë dhe mundësitë e kompjuterit, teknologjisë dhe programeve të softuerit (1 pikë) dhe vendosin t'i zbatojnë (1 pikë).<br>→ Di Gordon konsideronte se ajo është një ide e shkëlqyer dhe që kompjuteri do t'i bënte të gjitha gjërat në vend të saj, por ndodhi e kundërta nga ajo që priste (1 pikë). Xhorxh Grini ka kaluar shumë më pak kohë duke shkruar romanin e dytë, për shkrimin e të cilit ka shfrytëzuar NewwNovelist dhe mendon se ky program i ka ndihmuar në zhvillimin e kreativitetit (1 pikë).<br>**gjithsej 8 pikë** |
| **kërkesa e tretë** | **Nxënësi:**<br>→ paraqet pajtimin ose mospajtimin e tij me profesoreshën Megi Boden(1 pikë) dhe me argumente e shpjegon qëndrimin e tij (1 pikë + 1 pikë për sqarim më të plotë).<br>**gjithsej 3 pikë** |

**Struktura gjuhësore dhe ndërtimore e tekstit - 11 pikë**

| Leksiku | Drejtshkrimi | Lidhshmëria | Struktura ndërtimore e tekstit |
|---|---|---|---|
| → Vlerësohet origjina-liteti i shprehjes gjatë hartimit të esesë, pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, me gabime minimale.<br><br>**Gjithsej 3 pikë** | → rrespektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore (koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve **për** dhe **mbi**, përemrit **i vet/i tij**, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: **lidhur me këtë**, **duke marrë parasysh** dhe i përemrave: **që, i cili, e cila, të cilët** etj., përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale.<br>**2 pikë**<br>→respektimi i normës drejtshkrimore ( shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave **r/rr, dh/ll, k/q, s/z, k/g, ç/q, gj/xh, e/ë**, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores **ë**, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja **j**<br><br>**2 pikë**<br>**Gjithsej 4 pikë** | → lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve<br><br>**2 pikë** | → lidhja e mirë e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin)<br><br>**2 pikë** |

| Leksiku | Drejtshkrimi | Lidhshmëria | Struktura ndërtimore e tekstit |
|---|---|---|---|
| - përsëritja e fjalëve dhe shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta **2 pikë** | → respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve **për** dhe **mbi**, përemrit **i vet/i tij**, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit **lidhur me këtë, duke marrë parasysh** dhe i përemrave: **që, i cili, e cila, të cilë**t etj. **1 pikë**<br><br>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta (p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores **ë**, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja **j**<br><br>**1 pikë**<br>**Gjithsej 2 pikë** | - lidhshmëria e mirë në nivel të tekstit me palidhshmëri të përkohshme në nivel të paragrafëve **1 pikë** | - palidhshmëria e përkohshme e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike të tij (nuk ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin)<br><br>**1 pikë** |
| - përsëritja e fjalëve dhe shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta **1 pikë** | | | |

**VËREJTJE:**

- → **Me 0 (zero) pikë vlerësohet punimi i parregullt, i palexueshëm dhe ai që nuk ka shembuj të kërkuar leksikorë qoftë në përmbajtje apo në gjuhë.**
- → **Për dorëshkrimin që lexohet vështirë merret 1 pikë.**
- → **Duhet respektuar kërkesën për numrin e fjalëve ±10% (vlerësohet hartimi i cili ka prej 225 deri në 330 fjalë: nëse eseja ka më pak se 225 fjalë, NUK LEXOHET FARE, kurse në 330 fjalë ndërpritet leximi).**

Detyrat/pyetjet - numri i pikëve: **30** (60 %)
Shkrimi i esesë - numri i pikëve: **25** (40 %)
Numri i përgjithshëm i pikëve në test: **55** (100 %)

# 9. LITERATURA


Prof. dr. Rami Memushaj, “Bukuria e gjuhës”, Gjuha shqipe për klasën e parë të gjimnazit të përgjithshëm, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë 2007

Prof. dr. Ardian Marashi, “Letërsia 1”, për klasën e parë të gjimnazit të përgjithshëm, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë 2007

Prof. dr. Rami Memushaj, “Bukuria e gjuhës”, Gjuha shqipe për klasën e dytë të gjimnazit të përgjithshëm, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë 2008

Prof. dr. Rami Memushaj, “Bukuria e gjuhës”, Gjuha shqipe për klasën e tretë të gjimnazit të përgjithshëm, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë 2009

Historia e letërsisë shqipe, Rilindja, Prishtinë, 1989

Prof. Gjergj Zheji, Prof. As. Dr. Natasha Xhafka “Fjalor enciklopedik letrar”, Tiranë, 2001

Bahri Beci “Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë”, Tiranë, 2004

Grup autorësh “Mësuesi, shkolla dhe shoqëria”, Prishtinë 1997

Grup autorësh “Studio gjithçka, arsyes vendin e parë”, Tiranë, 1998

Bardhyl Musai “Metodologji e mësimdhënies”, Tiranë, 2003

Grup autorësh “Zhvillimi i mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit”, Tiranë, 1998

Prof. Gjergj Zheji, Prof. As. Dr. Natasha Xhafka “Komenti letrar” (në ndihmë të mësuesve), Tiranë, 1998

Sabri Hamiti “Vetëdija letrare”, Rilindja, Prishtinë, 1989

Dr. Agim Vinca “Struktura e zhvillimit të poezisë së sotme shqipe (1945-1980)”, Rilindja, Prishtinë, 1985

Bajram Krasniqi “Kode të ligjërimit letrar” Rilindja, Prishtinë, 1988

Rexhep Ismajli “Gjuhë dhe etni”, Rilindja, Prishtinë, 1991

Ibrahim Rugova “Strategjia e kuptimit”, Rilindja , Prishtinë 1980

Anton Berisha “Shumësia kuptimore”, Rilindja, Prishtinë, 1990

Rexhep Qosja “Histori e letërsisë shqipe”(Romantizmi I, II, III), Rilindja, Prishtinë, 1984, 1986

Milivoje Sollar “Teoria e letërsisë”, Prishtinë, 1978

R. Velek/ O.Voren “Teoria e letërsisë”, Prishtinë, 1982

Stefan Çapaliku “Letërsia e interpretuar”, Tiranë, 1998

Isuf Zeneli, Bazat e standardizimit dhe vlerësimit në arsim, Prishtinë, 2003

qendra e provimeve

MASA E
VËRTETË E
NJOHURIVE

Vako Gjuroviq p.n., 81 000 Podgoricë
ic@iccg.co.me, www.iccg.edu.me